

## Një vështrim historik mbi zhvillimin e vlerave humane në Shqipëri dhe situatën aktuale

*Eva Ndrio de Carvalho*<sup>1</sup>

*Lourenço Xavier de Carvalho*<sup>2</sup>

*Gert Guri*<sup>3</sup>

### **Abstract**

Ky artikull ofron një pasqyrë mbi karakteristikat e vlerave humane, apo të njohura ndryshe si vlerat universale, në realitetin shqiptar duke u përqendruar kryesisht në: 1) operacionalizimin e vlerave universale për të mundësuar paraqitjen e një kuadri të vlerave humane të cilat janë të pranishme sot në Shqipëri; 2) karakteristikat e zhvillimit të këtyre vlerave në shoqërinë shqiptare - duke nisur me periudhën e krijimit të shtetit shqiptar dhe formimit të shoqërisë moderne shqiptare - si parakusht për të kuptuar në mënyrë dinamike situatën aktuale të këtyre vlerave; 3) disa rekomandime se si vlerat humane mund të integrohen më mirë në kurrikulat shkollore, por edhe mundësinë që ka sistemi i edukimit për të transmetuar në një mënyrë sa më interesante dhe inovative këto vlera tek brezi i ri.

**Terma thelbësorë në artikull:** vlerat humane, mënyra e transmetimi të vlerave, qëllimi i vlerave, mënyra e ddukimit me vlerat humane (institucionale vs jo-institucionale), mjeti më i rëndësishëm për trasmetimin e vlerës, vlerësimi i një vlere humane sipas rëndësisë me të cilën konceptohet në shoqëri.

*Qershor 2020*

---

<sup>1</sup> Lektore, Universiteti i Vlerave, Instituti Luzo Ilir për Zhvillimin Njerëzor në Portugali.

<sup>2</sup> Lektor, Universiteti i Vlerave, Instituti Luzo Ilir për Zhvillimin Njerëzor në Portugali.

<sup>3</sup> Lektor, Universiteti i Trentos, Itali.

## 1. Hyrje

Ky artikull ka si qëllim të ofrojë një pasqyrë mbi karakteristikat e vlerave humane ose të njohura ndryshe si universale, ashtu si dhe rreth nevojës që paraqitet sot në Shqipëri për zbatimin dhe forcimin e këtyre vlerave. Sipas Hoffe (2004) vlerat humane bëjnë pjesë në kategorinë e vlerave themelore që janë të vlefshme për të gjithë njerëzimin dhe janë pjesë e përvojës së brendshme të realitetit, e cila shkon përtej marrëveshjeve shoqërore të natyrës politike, duke paraqitur një natyrë shumë të ndjeshme (Schmidt & Walach 2014). Artikulli përqendrohet kryesisht në tre aspekte: a) paraqitjen e një kuadri të vlerave humane të cilat janë të pranishme sot në Shqipëri; b) mënyrën se si ky kuadër vlerash është zhvilluar në mënyrë dinamike si një mundësi për të kuptuar situatën aktuale; c) disa rekomandime se si vlerat humane mund të integrohen më mirë në kurrikulat shkollore.

Për arritjen e këtij qëllimi, artikulli nis me përgatitjen e një kuadri analitik i cili është i nevojshëm për të percaktuar jo vetëm konceptin e vlerave humane por edhe mënyrën se si këto vlera duhet të vëzhgohen dhe operacionalizohen. Një këndvështrim i disa prej teorive dhe metodologjive kryesore mbi vlerat humane mundëson identifikimin e një modeli analitik, i cili i shikon ato brenda një kuadri ku përfshihen si mënyrat e transmetimit të tyre por edhe ndërlidhjen e tyre me kompetencat shoqërore të një individi.

Operacionalizimi i vlerave humane realizohet duke evidentuar fillimisht ato vlera të cilat konsiderohen si të domosdoshme për një individ që kërkon të ketë një jetë të suksesshme, që do të thotë. arritjen e objektivave personale në harmoni me ato shoqërore. Bazuar në metodologjinë e konvergencës, e cila konsiston në ndërthurjen e vlerave humane me kompetencat individuale, Instituti Luso-Ilir për Zhvillimin Njerëzor ka arritur të vëzhgojë dhe operacionalizojë vlerat më të domosdoshme humane të cilat konsiderohen si vlera themelore për një individ kuptimplot. Kjo u arrit nëpërmjet realizimit dhe krahasimit të pyetësorëve drejtuar popullsisë portugeze në vitet 1999, 2009 dhe 2016, në të cilët portugezet u pyetën se cilët ishin qëllimet më të rëndësishme të jetës për veten e tyre dhe për të tjerët, mes shumë pyetjeve të tjera, duke patur si qëllim të mateshin vlerat personale, shoqërore dhe qytetare prioritare.

Duke mos patur aktualisht të dhëna parësore të ngjashme për popullsinë shqiptare, për të dhënë një dimension mbi vlerat humane në realitetin shqiptar, artikulli analizon karakteristikat e këtyre vlerave në tre periudha historike të shtetit shqiptar, duke u

përqendruar më tepër në periudhën aktuale, ku sisteme politike, shoqërore dhe ekonomike të ndryshme kanë patur një ndikim të rëndësishëm në evolucionin e këtyre vlerave.

Për t'iu përgjigjur këtij qëllimi si edhe duke konsideruar aspektin evolutiv të këtyre vlerave në Shqipëri, artikulli është organizuar në katër seksione:

1. Kuadri teorik dhe indentifikimi i modelit analitik;
2. Vlerat humane në një këndvështrim historik;
3. Vlerat humane në realitetin e sotëm shqiptar dhe si transmetohen ato;
4. Konkluzionet dhe disa rekomandime për mënyrën se si këto vlera mund të zhvillohen dhe konsolidohen më tej.

## **2. Kuadri Teorik**

Ky seksion i artikullit përqëndrohet në krijimin e një mekanizmi analitik për të hulumtuar se si vlerat dhe kompetencat ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Sipas Koskins dhe Crick (2006) një kompetencë i referohet një kombinimi ndërmjet njohurive, aftësive, kuptimit të vlerave, zakoneve dhe dëshirave. Kjo sepse kompetencat nënkuptojnë marrëdhënie ndërmjet aspektit insitucional, aktiviteve të ndërmarra për të kuptuar dhe aplikuar këto aftësi, si edhe vlerave që përfitohen apo zbatohen gjatë këtij procesi.

Ky model sistemik, kur flasim për edukimin mbi vlerat, është rezultat i faktit se edukimi nuk ndodh në një ambient i cili është i zhveshur nga vlerat tradicionale, pasi këto të fundit dhe aspekti insitucional i edukimit janë në një ndërveprim të vazhdueshëm (Giddens 1984). Duhet patur parasysh që këto cilësi, të cilat krijohen nëpërmjet këtij ndërveprimi lidhen me aftësi individuale për të menduar, kuptuar apo arsyetuar. Në këtë këndvështrim, kompetencat shoqërore mbështeten në një proces zhvillimi konstant duke nisur me vlerat e krijuara në ambientin shoqëror/familjar, në të cilat një individ ekspozohet që nga fëmijëria në një proces të natyrshëm dhe jo insitucional mësimi (Nonaka, 1991), por edhe në mënyrën se si insitucionet e edukimit funksionojnë, si ofrojnë informacionin, cilat janë metodologjitë që përdoren dhe vlerat që konsiderohen si të rëndësishme për pajisjen e individit me kompetencat e nevojshme shoqërore. Në një periudhë të zhvillimit aktual shoqëror, e cila karakterizohet nga një ndërtim shumëdimensional, është e nevojshme që koncepti i kompetencave të vendoset në një kontekst i cili pasqyron stadin e zhvillimit në një realitet shumëplanësh dhe global (Morin,

1999). Në këtë rrafsh është e rëndësishme që të evidentohen ato të cilat mund të konsiderohen si kompetenca shoqërore thelbësore apo të domosdoshme. Në një model gjithëpërfshirës sipas OECD (2001), kompetencat shoqërore kryesore mund të konsiderohen të gjithë ato kompetenca të cilat janë të domosdoshme për një “ *jetë të suksesshme dhe një shoqëri që funksionon normalisht*”.

Këto kompetenca nuk mund të shihen të shkëputura nga dimensionimi i atyre që janë të mishëruara nëpërmjet aspektit jo-institucional apo mësimi i heshtur dhe i pavetëdijshëm, i cili fillon që nga fëmjësia dhe në mënyrë të vazhdueshme ndikon në formimin e vlerave dhe kompetencave të një individi, shpeshherë në simbiozë apo në mospërputhje me vlerat e ofruara nëpërmjet sistemit shkollor (aspekti institucional) (Nonaka 1991). Sipas Giddens (1984) këto kompetenca, të cilat përfitohen në mënyrë të heshtur, duhet të përforcohen apo ndikohen nga kompetencat shoqërore transversale, të cilat ofrohen nga sistemi institucional (shkollimi apo aktivitete të tjera të integruara në mënyrë institucionale). Pra krijimi i kompetencave shoqërore duhet parë si një proces në të cilin harmonizohen kompetencat e fituara në mënyrë të heshtur (jo-institucionale) me kompetencat e ndër-rrafshta që ofron sistemi institucional dhe që janë të një rëndësie të dorës së parë në realitetin global në të cilin jetojmë (Bertrand, 2001). Nga ky ndërveprim konstant krijohen kompetencat e domosdoshme për një jetë të suksesshme dhe një shoqëri funksionale (Kirsch 2001).

Përveç rrafshit funksional apo mënyrës se si transmetohen dhe formohen këto kompetenca, një tjetër aspekt i cili influencon në krijimin tyre është edhe mënyra e transmetimit të këtyre kompetencave (Lickona, 1991). Kështu, si pasojë e globalizimit dhe zhvillimit të teknikave të reja pedagogjike në vitet e fundit, vihet re një ndryshim në lidhje me njohurinë bazë të vlerave humane e cila arrijt kryesisht nëpërmjet kuptimit të teksteve dhe komunikimit me shkrim, tek ajo që përkufizohet si njohuri në të cilën ndërthuren vlerat humane me kompetencat bazë për të mësuar dhe zbatuar këto vlera (përfshirë këtu ndikimin në rritje të medias apo faktorëve politikë, ambientit rrethues, dhe teknikave dixhitale si interneti apo edhe mediat sociale) (Morin 1999). Në këtë mënyrë, vlerat humane nuk mund të shihen më të shkëputura nga kompetencat – një numër aftësish, njohurish dhe strategjish – të nevojshme për t’i zbatuar ato përgjatë gjithë jetës dhe mbi të gjitha në kontekste dhe mënyra të larmishme ndërveprimi.

Në perspektivën shumëplanëshe të vlerave dhe mënyrën e transmetimit të tyre në një realitet gjithnjë e më global, një dimension më i saktë mund të ofrohet nëpërmjet konceptit të konvergencës (Carvalho 2013; Ndrio 2019). Kështu vlerat humane mund të kuptohen si një seri procesesh, në një kontekst edukimi formal ose jo-formal që kanë si qëllim zhvillimin e kompetencave të cilat deri tani janë ushtruar nëpërmjet iniciativave tradicionalisht të lidhura me fushat e Zhvillimit Personal dhe Shoqëror, Edukimit e me Normat Shoqërore dhe Qytetare, Edukimit me Vlerat e Demokracisë, etj. Aplikimi i metodologjisë së konvergencës ka disa avantazhe të cilat mundësojnë një edukim më të mirë me vlerat dhe krijimin e kompetencave shoqërore:

- Ofron një perspektivë shumëplanëshe/gjithëpërfshirëse duke kombinuar aktivitetin, kapacitetin dhe vlerën e secilit individ për të thithur dhe zbatuar këto vlera në tërësinë e dimensioneve të tij/saj intelektuale, fizike, emocionale dhe shpirtërore;
- Nënvizon elementët praktikë dhe realë të kompetencës shoqërore, si një aspekt të rendësishëm në aktivitetet e përditshme të individit;
- Konsideron kuptimin e këtyre njohurive shoqërore në tërësinë e tyre si një element që ka për qëllim mirëqënien individuale dhe shoqërore. Këto njohuri kuptohen si një harmonizim ndërmjet njohurive individuale dhe atyre shoqërore, njohurive të fituara në mënyre të heshtur dhe atyre mësuara në mënyrë institucionale.
- Kjo metodologji është në të njëjtën linjë me kompetencat kryesore të përgatitura nga Komisioni Evropian (2006) mbi Mësimin e Vazhdueshëm (Life Long Learning) apo me programin DeSeCo të OCED-së (2003).

Studime të ndryshme ndajnë mendimin se qëllimi përfundimtar i sistemit shkollor por edhe i atij jo-institucional i vlerave tradicionale është edukimi i fëmijëve dhe të rinjve me normat e plota të vlerave humane apo siç njihen ndryshe edhe edukimi i personave me karakteristikat e “një personi me vlera” apo e “një të rrituri me vlera qytetare” (Arthur dhe Davidson 2000). Këto vlera i referohen kryesisht edukimit të individëve me cilësi të karakterit të cilat synojnë një ndërveprim në harmoni të plotë me shoqërinë, ndërtimin e aftësive të nevojshme në vendin e punës, si edhe zbatimin e përgjegjësive qytetare.

Megjithatë pyetja kryesore të cilës duhet ti përgjigjen mjaft studies dhe specialistë të angazhuar në këtë fushë është: si mund ti operacionalizohen këto vlera për të mundësuar prezencën e tyre si një hap i parë për të kuptuar si dhe ku duhet ndërhyrë për të edukuar sa më shumë dhe sa më mirë të rinjtë me vlera humane si qytetarë të së nesërme? Duke

aplikuar metodologjinë e konvergences, Instituti Luzo-Ilir për Zhvillimin Njerëzor (Carvalho 2013; Ndrio 2019) ka arritur që t'i operacionalizojë edukimin mbi vlerat duke ndërthurur vlerat universale me kompetencat individuale kontemporane.

Për këtë është e nevojshme të kuptohet në cilën mënyre shoqëritë i integrojnë vlerat e përjetshme në kontekste të ndryshme të jetës bashkëkohore, prandaj iLIDH tentoi të masë rëndësinë e vlerave strukturuese të qytetarimeve njerëzore në bazë të një liste të qëllimeve themelore të jetës, në të cilat njerëzit investojnë përpjekjet dhe sistemet edukative investojnë burime, të ndërgjegjshme ose jo të këtij realiteti.

Ndër disa prej dimensioneve dhe treguesve të analizuar në sondazhet e iLIDH, ky është një grup treguesish që sintetizon dhe ilustron temën në fjalë, fakt ky për të cilin u zgjodh si një kornizë për analizë gjatë gjithë këtij dokumenti.

<b>Qëllime themelore të jetës</b>	<b>Vlera në të cilën bazohen</b>
1. Të kesh një familje të qëndrueshme	Familja
2. Të duash dhe të jesh i dashur nga të tjerët	Dashuria
3. Të jesh i nderuar	Nderi
4. Të ndihmohesh të tjerët	Solidariteti
5. Të jesh një profesionist i aftë	Përsosmëria
6. Të besosh (si në aspektin fetar ashtu edhe në atë shoqëror)	Besimi
7. Të kesh një pozicion shoqëror të respektuar	
8. Të jesh i pasur	
9. Të kesh influence dhe pushtet	
10. Të jesh i famshëm	

Siç mund të shikohet në tabelën më sipër, gjashtë qëllimet e para të jetës shoqërohen qartësisht me vlera humane të cilat njihen në formë konsensuale në lidhje me përfitimin që kanë për individin, për marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe për qytetarinë. Katër qëllimet e fundit të jetës i referohen prioriteteve tërësisht materialiste dhe individualiste, të

shoqëruara me një kulturë konsumimi bashkëkohore egocentrike, e cila kërcënon qëndrueshmërinë e zhvillimit personal, marrëdhëniet njerëzore dhe globale. Prandaj, këto nuk shoqërohen me vlera të favorshme për zhvillimin njerëzor, megjithatë nëse do te kihet parasysh pozicioni i tyre relativ, përkatësisht ndërlidhja dhe nënshtrimi i tyre me vlera të tjera humane, mund t'i bëjë ato të mos i përkasin nocionit të "anti-vlerave". Raste të tilla janë, për shembull, nënshtrimi i fuqisë, i ndikimit dhe pasurisë materiale ndaj vlerave të solidaritetit dhe të dashurisë për qëniet e tjera njerëzore dhe natyrën.

Sikundër e shpjeguar edhe më lart, këto vlera mund të kuptohen duke u analizuar jo në një proces statik por në një evolucion të vazhdueshëm të influencuara dhe të pashkëputura nga periudha dhe karakteristika shoqërore apo politike të caktuara. Në këtë drejtim, në këtë artikull situata aktuale e vlerave humane në Shqipëri mund të kuptohet duke parë evolucionin e tyre në historinë moderne të shtetit shqiptar (duke nisur nga vitit 1920). Kjo analizë ndërkohore do të na japë mundësinë për të kuptuar dhe shpjeguar disa nga karakteristikat e vlerave humane në Shqipërinë e sotme. Në këtë analizë do të përfshihet edhe influenca që kanë mbi këto vlera:

- a. format e edukimit (institucionale vs jo-institucionale apo tradicionale);
- b. mjetet e komunikimit të përdorura për transmetimin e këtyre vlerave (nëpërmjet trashëgimisë kulturore dhe familjes), kuptimit të teksteve apo komunikimit me shkrim, si edhe ndikimin në rritje të medias, teknikave dixhitale (si interneti ashtu edhe mediat sociale).

Kjo analizë do të kryhet duke konsideruar ndarjen e historisë së shtetit shqiptar në tre periudha të ndryshme, si nga ana shoqërore, politike apo ekonomike, të cilave i përgjigjej një sistem vlerash të zhvilluara për qëllime dhe me mjete të ndryshme:

- 1) Periudha e krijimit i shtetit shqiptar deri në fundin e Luftës së Dytë Botërore (vitet 1920 - 1944);
- 2) Periudha e vendosjes dhe zbatimit të sistemit komunist në Shqipëri (vitet 1944 - 1990);
- 3) Periudha e tranzicionit dhe forcimit të institucioneve demokratike shqiptare (vitet 1990 - sot).

Qëllimet / vlerat humane në secilën periudhë do të analizohen duke përdorur për secilën prej tyre , modelin e prezantuar në mënyrë skematike në Tabelën 1.

**Tabela. 1**

Qëllime / Vlerat	Mënyra e Edukimit (institucionale vs jo-institucionale)	Mjeti më influent për trasmetimin e vlerës	E konceptuar si
Të duash dhe të jesh i dashur nga të tjerët	P.sh. Shkolla	P.sh. Tekstet shkollore	Vlerë personale, shoqërore ose fetare, e rëndësishme ose jo

### 3. Vlerat humane në një këndvështrim historik

Sikundër e shpjeguar edhe më lart, përvoja e takon vlerave humane dhe zhvillimit të tyre në Shqipëri, aspekti historik ka patur një rol të rëndësishëm pasi ndryshimet gjithëpërfshirëse si në aspektin politik, ekonomik dhe shoqëror ndodhën në një kohë të shkurtër dhe me një amplitudë ndryshimi mjaft të mprehtë. Në këtë prizëm dy janë periudhat historike qartësisht të ndryshme nga njëra-tjera: a) periudha e krijimit të shtetit shqiptar deri në fundin e luftës së dytë botërore, ose siç njihet ndryshe periudha midis dy luftërave botërore; b) periudha e vendosjes së sistemit komunist.

#### 3.1 Vlerat Humane në periudhën midis dy luftërave

Krijimi i shtetit të ri shqiptar, një proces i nisur me shpalljen e pavarësisë dhe i kompletuar me vendimin e Konferencës së Paqes në vitin 1920, karakterizohet nga një përpjekje për një modernizim, si në aspektin institucional dhe ekonomik, ashtu edhe në atë shoqëror (Albanian History 2006). Megjithatë Shqipëria trashëgonte një rend shoqëror gati arkaik me një sistem ekonomik gjysëm feudal dhe me një numër minimal shkollash dhe institucionesh publike që kishin për qëllim edukimin me vlerat shoqërore të brezit të ri në përgjithësi (Dede 1995). Me një popullsi e cila ishte 81% analfabete, me një numër të kufizuar mjesh të informacionit, si në numër ashtu dhe edhe shpërndarje, mënyra kryesore për trasmetimin e vlerave ishin familja dhe institucionet e kultit (Drost 1995). Si rezultat i kësaj situatë, i kushtohej më shumë rëndësi edukimit në familje me vlerat kryesisht të karakterit moral dhe atij fetar (Ermenji 1994). Vlerat humane ishin të limituara në aspektin moral dhe ekzistenca e kastave ekonomike dhe shoqërore krijonte një lloj hendeku përvoja i takon mundësisë së pajisjes me aftësi profesionale apo për të shpresuar në ndryshimin e rangut shoqëror (Beqja 1986). Zakonisht kishte një kalim



brenda familjes së një profesioni nga babai tek fëmijët, kryesisht meshkuj. Me një nivel emancipimi mjaft të ulët (femrat përbënin më pak se 0.1% të forcës së punës në qytet dhe shërbime), aspekti profesional ishte një mundësi gati e monopolizuar nga meshkujt (Dushku 1991). Mangësia në aspektin e edukimit të vlerave jashtë rrethit familjar krijonte përparësi të vlerave morale dhe atyre të kultit.

Tabela 2 paraqet të përmbledhura karakteristikat e vlerave humane dhe mënyra e transmetimit dhe edukimit të tyre në këtë periudhë.

**Tabela 2**

Qëllime / Vlera	Edukimi institucional ose jo-institucional	Mjeti më influent për trasmetimin e vlerës	E konceptuar si
Të kesh një familje të qëndrueshme	Jo-institucionale	Familja	Vlerë personale/shoqërore
Të duash dhe të jesh i dashur nga të tjerët	Kryesisht jo-institucional	Familja/Objekti kultit	Vlerë personale/fetare
Të jesh i nderuar	Jo-institucional	Familja	Vlerë personale/shoqërore
Të ndihmohesh të tjerët	Jo-institucional	Familja/Feja	Vlerë personale/fetare
Të jesh profesionist i aftë	Kryesisht jo-institucional	Familja/Punëdhënësi	Vlerë personale/shoqërore
Të kesh besim	Kryesisht jo-institucional	Familja/Feja	Vlerë shoqërore/fetare
Pozicion shoqëror i respektuar	Kryesisht jo-institucional	Familja	Vlerë personale/shoqërore
Të kesh influencë/pushtet	Pothuajse jo-ekzistente		
Të jesh i famshëm	Pothuajse jo-ekzistente		

### **3.2 Vlerat Humane në Periudhën e Rregjimit Komunist**

Periudha e rregjimit komunist mund të konsiderohet si një periudhë në të cilën zhvillimi i vlerave ishte diametralisht i kundërt krahasuar me periudhën e mëparshme. Si në të gjitha sistemet totalitare, rëndësia e ideologjizimit të masave me normat e moralit komunist kërkonte një zhvendosje të shpejtë dhe radikale të sistemit të krijimit dhe transmetimit të vlerave nga familja apo objektet e kultit tek institucionet shtetërore, kryesisht shkollat por edhe organizatat e fëmijëve dhe të rinje si ato të Fatosit, Pionerit apo të Rinisë (Arbnori 1993). Këto të fundit kishin si qëllim ideologjizimin me vlerat e

moralit komunist<sup>4</sup> në periudhën jashtë-shkollore (Fico 1997). Kështu, që nga fëmijëria ushtrohej një program i mirë-organizuar indoktrinimi, i gërshtuar edhe me aktivite shoqërore të cilat kishin si qëllim praktikimin e këtyre normave siç ishin rrethet jashtë-shkollore të edukimit për fëmijët apo aksionet dhe puna vullnetare për të rinjtë (Alia 1988).

Ky centralizim i metodave të edukimit dhe ushtrimit të tyre përdori të gjitha mjetet e mundshme, nga shtypi, radio/televizioni deri tek kinematografia apo letërsia dhe arti, të cilat çuan nëzbehjen e rolit të familjes (Halliday 1986). Regjimi komunist propagandonte me forcë kundërshtimin dhe luftën brenda familjes në rastet kur kjo bëhej për të zëvendësuar vlerat tradicionale me ato të diktuarës nga rendi i ri shoqëror (Hoxha 1969). Kjo u gërshtua edhe me shpalljen e institucioneve të kultit si të jashtëligjshme në vitin 1967 (Institute of Social Sciences 1978). Në asnjë vend tjetër komunist, shteti nuk arriti të shpallte fenë si të jashtëligjshme, shkak i cili solli si rezultat një situatë gati monopoliste të kontrollit të vlerave nga institucionet shtetërore (Klosi 1994). Këto hapa u shoqëruan nga një fushatë të alfabetizimit masiv, e cila u finalizua në vitin 1955, kur në Shqipëri nuk kishte më asnjë person nën moshën 40 vjeçare që të ishte analfabet (Beqja 1986). Ky hap mundësoi penetrimin e ambientit familjar nga mjetet e informacionit dhe propagandës. Një tjetër fushatë masive ishte ajo e emancipimit të gruas, si rezultat i së cilës në vitin 1989, ndarja gjinore e forcës së punës pasqyrore saktësisht atë demografike (për femrat puna ishte e detyrueshme) (Albanian History 2006). Ky depërtim dhe masivizim i përhapjes së këtyre masave rivendosoi një ekuilibër të ri në promovimin e vlerave humane, ku individi duhet të sakrifikohej për shoqërinë, ku pasuria apo fama individuale ishin pothuajse të pakuptimta, ndërsa normat shoqërore kishin prioritet mbi ato tradicionale apo familjare (normat fetare ishin tashmë të jashtëligjshme) (Klosi 1994).

Në tabelën 3 janë paraqitur të përmbledhura karakteristikat e këtyre vlerave dhe mënyra e transmetimit të tyre. Vlen të thekshohet një situatë diametralisht e kundërt me tabelën 2, si në rëndësinë ashtu edhe në mjetet e përhapjes së tyre.

### Tabela 3

---

<sup>4</sup> Vlerat e moralit komunist përfshijnë të gjithë atë kuadër vlerash ideologjike, të cilat synonin politizimin shoqëror me doktrinën komuniste. Të gjitha vlerat e tjera konsideroheshin si funksione variabël të moralit komunist i cili kishte përparësi mbi çdo vlerë tjetër si në mënyrën e transmetimit ashtu edhe në përsa i takon zbatimit të këtyre vlerave.

Qëllime/ Vlera	Edukimi institucional ose jo-institucional	Mjeti më influent për trasmetimin	E konceptuar si
Të kesh një familje të qëndrueshme	Institucional dhe jo institucional	Familja/Organizatrat	Vlerë personale/shoqërore
Të duash dhe të jesh i dashur nga të tjerët	Kryeisht institucional	Shkolla/Familja	Vlerë personale/shoqërore
Të jesh i nderuar	Kryeisht institucional	Shkolla/Familja	Vlerë personale/shoqërore
Të ndihmohesh të tjerët	Kryeisht institucional	Shkolla/Organizatrat	Vlerë shoqërore
Të jesh profesionist i aftë	Institucional	Shkolla/Qendra Punës	Vlerë shoqërore
Të kesh besim	Institucional	Shkolla/Organizatrat	Vlerë shoqërore dhe ideologjike
Pozicion shoqëror i respektuar	Kryeisht institucional	Shkolla/Qendra Punës	Vlerë shoqërore/personale
Të kesh influencë/pushtet	Pothuajse jo-ekzistente		
Të jesh i famshëm	Pothuajse jo-ekzistente		

#### 4. Vlerat Humane në Realitetin e Sotëm Shqiptar dhe Transmetimi i tyre

Në një këndvështrim analitik të vlerave humane në realitetin shqiptar, nga përmbysja e sistemit komunist deri në periudhën aktuale, do të dallonim një ndarje në dy periudha kryesore:

- a. periudha e parë menjëherë pas përmbysjes së sistemit komunist dhe fillimit të tranzicionit politik, ekonomik dhe shoqëror;
- b. periudha e dytë fillon me rishikimin dhe integrimin e vlerave humane në mënyrë të organizuar dhe standartizuar në edukimin shkollor para-universitar.

Nisur nga fakti se në këto dy periudha vlerat transmetohen dhe integrohen në mënyra të ndryshme, në këtë artikull analizohen të ndara duke i kushtuar më shumë vëmendje situatës aktuale.

##### 4.1. Vlerat Humane Gjatë Tranzicionit Shqiptar

Përmbysja e sistemit dikatorial u shoqërua me ndryshime të vullshme dhe disa herë kaotike në të gjitha fushat e jetës duke i lënë vend periudhës së tranzicionit, i cili njihet të ketë qenë nga më të vështirët dhe traumatikët pasi u bazua gjerësisht në zbatimin e *shock therapy* (terapia e shokut) (Burawoy et.al 1999). Megjithatë këto ndryshime ishin më të ndjeshme në aspektin shoqëror dhe për rrjedhojë në sistemin e edukimit mbi vlerat (Tarifa 1995). Menjëherë pas rrëzimit të regjimit komunist vihet re një mohim i gjithçkaje që

ishte ndërtuar në gati 45 vjet. Pavarësisht se, sikundër u theksua më lart, vlerat e promovuara gjatë regjimit komunist kishin një qëllim ideologjik, shumë prej këtyre vlerave, sidomos ato të edukimit shoqëror individual, apo siç njihej në atë periudhë edukata morale, mund të ruheshin apo të transformoheshin për të mos krijuar një zbrazëtirë të vlerave shoqërore (Sinani 2000). Kjo ishte më e pranishme në tre aspektet kryesore të edukimit shoqëror: shkolla, shoqëria dhe familja.

Moszëvendësimi i teksteve shkollore përkatëse me materiale të përshtatura apo te krijuara rishtaz me qëllim edukimin shoqëror në ciklin shkollor para-universitar krijoi një vakum në këtë aspekt të rëndësishëm të edukimit të brezit të ri (Pëllumbi 2002). Praktikisht nuk kishte asnjë lëndë e cila të fokusohet në edukimin mbi vlerat, i cili konsiderohej i një rëndësie joparësore, ndërsa filloi zëvendësimi i teksteve shkollore të cilat lidheshin me historinë, gjeografinë, gjuhën ose letërsinë (OSFA 1998). Ideologjizimi i skajshëm i shkollës gjatë periudhës komuniste bëri pothuajse të pamundur përdorimin e teksteve të mëparshme shkollore edhe në lëndë të cilat mund të dukeshin si immune ndaj ideologjizimit, siç ishin gjuhët e huaja apo edhe shkencat e natyrës (Langer 1993). E gjithë kjo përpjekje titanike, e cila kërkohej për rehabilitimin e teksteve shkollore, binte ndesh me fondet e pakta që kishte në dispozicion arsimit shqiptar në periudhën e parë të tranzicionit (UNDP 1998). Për më tej nuk u mendua për krijimin e disa broshurave, pershtatje të thjeshtë të teksteve apo zhvillimin në klasë të diskutimeve mbi tematikat e edukimit mbi vlerat, si mjete ndihmëse për të zgjidhur këtë mangësi kurrikulare. Do të nevojitej me shumë se një dekadë për sistemin shkollor për të rimarrë rolin e tij në këtë sipërmarrje. Në këtë mënyrë, sistemi i edukimit mbi vlerat pothuajse u la pas dore në këtë periudhë duke ia lënë në dorë familjes. Kjo mangësi e shkollës në këtë periudhë do të linte gjurmë në edukimin me vlerat tek brezi i ri, aq më tepër kur për 85% të shqiptarëve, roli i shkollës në këtë proces konsiderohej si nga më të rëndësishmit (i dyti pas familjes) (UNDP 2015).

Familja së bashku me klerin, sikundër e kemi shpjeguar edhe më lart, ishte një nga aktorët kryesorë të edukimit mbi vlerat në periudhën përpara vendosjes së sistemit komunist. Megjithatë, një indoktrinim i plotë për më shumë se 45 vjet nga shkolla i harmonizuar me punën e organizatave shoqërore të kontrolluara nga regjimi, influenca e të cilave fillonte nga sistemi parashkollor deri në fund të jetës së individëve e kishte tkurrur ndjeshëm rolin e familjes në këtë aspekt (Human Rights Watch 1996). Ky realitet komplikohet më tej po

të kemi parasysh situatën sociale dhe ekonomike në të cilën po kalonte vendi. Me një përqindje të lartë papunësie – në dy vitet e para të tranzicionit më shumë se 300.000 persona humbën vendin e punës brenda një viti – dhe me një mungesë të plotë të amortizatorëve socialë (Qeveria Shqiptare 1992), detyra kryesore e mjaft familjeve ishte mbijetesa ekonomike. Në këtë mënyrë rëndësia e edukimit mbi vlerat kaloi në plan të dytë. Në vitin 1994, 41% e familjeve e konsideronin edukimin e femijëve dhe të rinjve me vlerat humane si të një rëndësie themelore, por gjithsesi të një prioriteti më të ulët krahasuar me nevojën për të siguruar minimumin e nevojshëm jetik për mbijetesë (UNDP 2015). Mjaft të rinj ishin të detyruar të braktisnin shkollën për të ndihmuar familjen, ndërsa të tjerë filluan të konsiderojnë antivlerat si vlera (Dushku 1991). Në këtë periudhë daton edhe një nga shprehjet më emblematike të tranzicionit shqiptar për dikë i cili arrinte të siguronte një standard të mirë jetese në rrugë të paligjshme, duke e konsideruar si një profesionist të shkathët. Ky realitet kaq i vështirë për familjet, po bënte të pamunduar të ofronte për të rinjtë modelin e një individi me vlera humane, ndërkohë që të rinjtë konsideronin si model për t'u ndjekur, informalitetin dhe aktivitetet e jashtëligjshme, të cilat siguronin të ardhura të shpejta dhe pa shumë punë, siç ishin firmat piramidale (Leka 1998). Pra antivlera ishte kthyer në modelin për t'u ndjekur nga mjaft të rinj.

Kjo gërshetohej edhe me periudhën e rimëkëmbjes së institucioneve fetare, të cilat ishin shpallur si të jashtëligjshme për më shumë se 25 vjet. Institucioneve të kultit i duhej të rilindnin pas më shumë se 25 vjetësh, në një shoqëri e cila, për një çerek shekulli, kishte qenë komplet ateiste. Kështu që institucionet e kultit, jo vetëm që nuk kishin mundësinë e një organizimi të shpejtë në këtë drejtim, por edhe duhej akoma të rifitonin besimin e shoqërisë (Komiteti Shqiptar i Helsinkit 1993). Për më tepër kishte një konceptim të minimizuar nga opinioni publik lidhur me rolin e institucioneve fetare në Shqipëri. Kështu në vitin 1996, 80% e shqiptarëve mendonin se roli parësor i institucioneve të kultit është përhapja e vlerave fetare (e cila shihej si e ndarë nga vlerat shoqërore) (UNDP 2018). Disa inisiativa në bashkëpunim me organizata simotra nga vendet e tjera, të cilat kishin si qëllim të tërhiqnin brezin mbetën kryesisht sporadike dhe nuk mund të zëvendësonin rolin, të cilin duhet të luanin institucionet e kultit në edukimin me vlerat (Fico 1997).

Kështu, këto dy institucione tradicionale në edukimin mbi vlerat ndjeheshin të papërgatitura për të zëvendësuar qoftë edhe përkohësisht rolin e munguar të shkollës. Roli, i cili përkohësisht dhe në mënyrë të paplotë mund të mbulohej nga shoqëria civile

në përgjithësi dhe organizatat e shoqërisë civile të fokusuar në zhvillimin shoqëror dhe edukimin me këto vlera, mbeti gjithashtu i paplotësuar (OSFA 2000). Kontrolli dhe ideologjizimi i plotë i aktivitetit shoqëror nën regjimin komunist, jo vetëm që nuk kishte mundësuar ekzistencën e një shoqërie civile të pavarur, por edhe kishte krijuar mungesa të theksuara në formimin e kapitalit njerëzor për të organizuar dhe zhvilluar një shoqëri civile të pavarur (Krasniqi 2000). Në këtë periudhë organizatat e shoqërisë civile shfaqin kryesisht qëndrime klienteliste në drejtim të klasës politike apo donatorëve të huaj duke u kujdesur më shumë për mbi-ekzistencën e tyre se sa për të kryer rolin të cilin pritej që të luanin gjatë tranzicionit (Miqte e Shqipërisë 2001). Disa projekte sporadike në drejtim të edukimit mbi vlerat, efekti i të cilave zhdukej bashkë me përfundimin e projektit, mungesa e programeve afatmesme dhe afatgjata në këtë drejtim si nga ana e qeverisë ashtu edhe e donatorëve, si edhe mungesa e vizionit dhe përgatitjes së duhur të shoqërisë civile shqiptare për të kuptuar rëndësinë e trajtimit të këtij problemi, zbehën rolin e shoqërisë civile në edukimin e të rinjve me vlerat shoqërore (Drost 1995). Kjo qasje uli ndjeshëm perceptimin e publikut në lidhje me rolin pozitiv që mund të luante shoqëria shqiptare në lidhje me edukimin mbi vlerat, duke qënë se vetëm 30% e shqiptarëve e konsideronin shoqërinë civile si të aftë për të kontribuar në këtë proces (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë 2016).

Në këtë periudhë vihet re një papërgatitje e plotë dhe nënvlerësim i aktorëve kryesorë për rolin respektiv në prezantimin, mësimin dhe integrimin e vlerave humane në edukimin e të rinjve. Kjo mbeti një detyrë dytësore dhe shpeshherë e anashkaluar nga të gjithë këta aktorë, si rezultat i prioriteteve që kryesisht kishin të bënin me rilindjen, riorganizimin apo edhe mbijetesën e këtyre aktorëve gjatë periudhës së parë të tranzicionit të vështirë shqiptar. Si rezultat, procesi i edukimit mbi vlerat pati një zbehje dhe kurrje në shoqërinë shqiptare, pasojat e të cilave vihen re edhe sot. Tabela 4 ofron një vështrim mbi vlerat humane në këtë periudhë.

**Tabela 4**

Qëllime/ Vlera	Edukimi institucional ose jo-institucional	Mjeti më influent për trasmetimin e vlerës	E konceptuar si
Të kesh një familje të qëndrueshme	Jo-institucional	Familja	Vlerë personale
Të duash dhe të jesh i dashur nga të tjerët	Kryesisht jo-institucional	Familja	Vlerë jo e qënësishme

Të jesh i nderuar	Kryeisht jo-institucional	Familja	Vlerë personale
Të ndihmohesh të tjerët	Kryeisht jo-institucional	Familja	Vlerë parëndësishme
Të jesh profesionist i aftë	Kryeisht jo-institucional	Familja	Vlerë personale
Të kesh besim	Kryeisht jo-institucional	Familja	Vlerë parëndësishme
Pozicion shoqëror i respektuar	Kryeisht jo-institucional	Familja	Vlerë shoqërore/personale
Të kesh influencë/pushtet	Kryeisht jo-institucional	Shoqëria-Media	Vlerë personale/parësore
Të jesh i famshëm	Kryeisht jo-institucional	Shoqëria-Media	Vlerë personale/parësore

#### **4.2 Vlerat humane në periudhën aktuale**

Pas përfundimit të fazës së parë të tranzicionit kaotik shqiptar, shoqëria në përgjithësi dhe sistemi i edukimit, në veçanti, filluan të rikthehen konceptit të vlerave humane duke kuptuar domosdoshmërinë e këtyre vlerave (Freedom House 2005). Kjo edhe për vetë faktin se tashmë aktorët kryesorë të edukimit mbi vlerat e kishin kaluar fazën e parë, atë të *shock-therapy*, dhe kishin filluar të organizoheshin për të përmbushur misionin e tyre. Megjithatë të gjithë aktorët, p.sh. familja, objektet e kultit dhe shoqëria civile njohën një hap pozitiv në këtë drejtim, mund të themi se hapin më të rëndësishëm përpara e ka kryer sistemi shkollor (Mustafai 2015). Një rol të vecantë në këtë zhvillim ka rishikimi i plotë i sistemit shkollor, i programeve, i kurrikulave dhe metodologjive të përdorura nga sistemi i edukimit parauniversitar (Saliani 2020).

Aktualisht vlerat humane janë pjesë e kurrikulës bërthamë, e cila është e përbashkët për të gjithë nxënësit në sistemin arsimor, e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (Ministria Arsimit dhe Shkencës 2014). Në një zhvillim gradual duke pasqyruar, moshën aftësinë për të kuptuar dhe përjetësuar këto njohuri, vlerat humane fillojnë të shpalosen që në sistemin parashkollor, natyrisht duke vënë theksin mbi aspektet e zhvillimit vetjak dhe të një edukate dhe morali të mirëpritur shoqëror. Aspekti kryesor i vlerave humane është pjesë e “Kompetencave themelore” e cila ofrohet në sistemin e ciklit të detyruar (kryesisht nga klasa e V deri në klasën e IX) dhe në arsimin e mesëm (Veliaj 2011). Në këtë kornizë përfshihet ai grup vlerash për të cilat kanë nevojë të gjithë individët, konkretisht për: plotësim dhe zhvillim vetjak, qytetari aktive, përfshirje shoqërore dhe punësim.<sup>5</sup>

<sup>5</sup> Në këtë seksion informacioni i referohet kurrikulave shkollore në nivele të ndryshme të përpunuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si edhe materialeve të përgatitura nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit.

Në këtë grup kompetencash kemi një harmonizim midis vlerave humane të cilat fillojnë me zhvillimin individual për t'u shtrirë më tej në aspektin shoqëror ku mund të përmendim: një qytetari aktive, në të cilën individi angazhohet jo vetëm për një sjellje të denjë shoqërore por edhe për të qenë pro-aktiv në problemet shoqërore. Në fazën e parë të tranzicionit, qytetaria aktive u karakterizua kryesisht nga një indiferentizëm shoqëror i paprecedent (OSFA 1998), i cili tregon një reagim të kundërt me sjelljen në diktaturë, ku angazhimi shoqëror kuptohej si një mjet për të përgjuar apo mbajtur në kontroll individë apo grupe të caktuara shoqërore (Krasniqi 2004). Një agresivitet në rritje i sjelljes shoqërore, ku shpeshherë ligjin e bënte më i forti, i shtynte mjaft individë që të qëndronin indiferent, apo të shikonin interesin e tyre personal, duke evituar të angazhoheshin në problemet me karakter shoqëror (OOI 2000). Ndërkohë që për mjaft njerëz interesi shoqëror i përkiste së kaluarës, ku gjithshka ishte e të gjithëve.

Ajo që bie në sy është edhe përfshirja në aktivitetet shoqërore, e cila u anashkalua dhe u tkurr shumë gjatë periudhës së parë të tranzicionit. Si pasojë e pjesmarrjes në aktivitete shoqërore të detyruara, siç ishin puna vullnetare apo mbledhje të organizatave të ndryshme shoqërore, njerëzit kishin zhvilluar një lloj alergjie ndaj çdo aktiviteti shoqëror të papaguar (OSFA 1998). U krijua ideja se në ekonominë e tregut çdo gjë kryhet për të marrë një shpërblim material dhe të marrësh pjesë në aktivitete shoqërore për të ndihmuar vullnetarisht të tjerët konsiderohej si arkaizëm (Civici 2013). Shprehja më e njohur, e cila pasqyron pozicioninkundër pjesmarrjes në aktivitete shoqërore ishte: *“në ekonominë e tregut edhe zogu nuk këndon pa shpërblim”*. Kjo sjellje natyrisht që përlligjej edhe nga situata e vështirë ekonomike, ku për mjaft njerëz ishte e nevojshme të punonin me orë të zgjatura për të mbajtur familjen, duke patur pak interes dhe kohë për aktivitetet shoqërore (Partners of Albania 2001). Prandaj dhe ndërthurja e përfshirjes shoqërore në kurrikulat shkollore është mjaft e domosdoshme për të ndryshuar këtë trend.

Të jesh një profesionist i aftë shihet si një kompetencë për t'u rikonsideruar pas fazës së tranzicionit. Edhe në këtë rast vërehej një lloj alergjie ndaj së shkuarës, ku profesionet nuk përzgjidheshin kryesisht nga individi, por nga nevojat e shtetit për specialistë apo punonjës të kualifikuar në bazë të situatës ekonomike. Në këtë fazë punësimi i anashkalon nevojat që mund të kishte shoqëria, të cilat në një farë mënyrë përcaktojnë edhe nevojat e tregut të punës (Baçi 1998). Kështu dëshira për të zgjedhur vetë profesionin e preferuar në një prizëm krejt individual, ishte mjaft e dukshme në kërkesat për të konkuruar pranë



universiteteve të ndryshme. Për shembull, ndërkohë që në Fakultetin e Mjeksisë apo të Shkencave Juridike raporti midis numrit të konkurrentëve dhe vendeve për pranim ishte në një shkallë 150:1 në fakultete të tjera, siç ishin Matematika apo Fizika, nuk arrihej të plotësohej numri i vendeve të ofruara, pra kishte më shumë vende sesa kandidatë (Ministria e Arsimit dhe Shkencës 1999). Duke e konsideruar përgatitjen profesionale thjesht si një kompetencë individuale, mjaft të rinj nuk arrinin të shihnin edhe nevojat e tregut të punës, të cilat në një farë mënyrë pasqyroheshin në këto nevoja shoqërore për profesionistë. Për këtë qëllim rëndësia e përgatitjes së një profesionisti të aftë mund të konsiderohet si një tjetër hap pozitiv në kuptimin dhe restaurimin e edukimit të vlerave humane.

Përsa i përket zhvillimit vetjak, ku ndërthuren të gjitha ato vleraa të cilat, megjithësë në pamje të parë duket se kanë një karakter individual, kanë nje influencë të rëndësishme në vlerat humane, pasi zhvillimi individual është hapi i parë për të garantuar zhvillimin shoqëror dhe të njerëzimit, në përgjithësi.

Edukimi mbi vlerat në Shqipëri zhvillohen nëpërmjet metodologjive arsimore të përcaktuara qartë apo siç njihen ndryshe “*Shtatë kompetencave kyçe të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare*” (Ministria e Arsimit dhe Sportit 2014). Konkretisht këto kompetenca/aftësi, të cilat reflektojnë Kuadrin e Kompetencave Kryesore të Komisionit Evropian (European Council 2006), janë:

- 1) E komunikimit dhe e të shprehurit;
- 2) E të menduarit;
- 3) E të mësuarit për të nxënë;
- 4) Për jetën, sipërmarrjen dhe për mjedisin;
- 5) Personale;
- 6) Qytetare;
- 7) Digjitale.

Ekziston ne sistemin arsimor shqiptar një program që mat se cilat janë arritjet që duhet të ketë nxënësi përse i takon kompetencave themelore humane në nivele të ndryshme të shkollimit.

Procesi i të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët<sup>6</sup>, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencave personale, shoqërore dhe qytetare. Kjo fushë i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të globalizuar por bazuar mbi vlera gjithmonë e më gjithëpërfshirëse. Ky rol karakterizohet nga një proces i vazhdueshëm i hapjes së shoqërive në shkallë globale. Kjo tendencë shoqërohet me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje e globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxisin zhvillimin intelektual të nxënësve duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilët ata mund t’i përdorin në situata të ndryshme, duke i ndihmuar të njohin botën dhe të përballojnë situata të ndryshme në jetën e tyre (IZHA 2014).

Në fund të shkallës së parëtë arsimimit, nxënësi ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar apo lexuar. Kjo shpreh një nga rezultatet e të nxënit sipas kompetencës kyçe të:

- a. komunikimit dhe e të shprehurit;
- b. të menduarit;
- c. të mësuarit për të nxënë;
- d. individuale dhe qytetare.

Që në arsimin parashkollor, nxënësi mësohet të kuptojë dhe të evidentojë dy komponente të rëndësishëm nëpërmjet një teksti apo dëgjimit të një historie: i) komponentin dhe rolin e tij individual; ii) aspektin dhe impaktin qytetar të një aktiviteti të caktuar.

Shkalla e dytë përmban arsimin fillor dhe në fund të kësaj shkalle nxënësi prezantohet me kompetencën kyçepër jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Në këtë nivel nxënësit familjarizohen me kuptimin e sipërmarrjes së suksesshme dhe të qenit një profesionist i aftë duke përfshirë ketu edhe mjedisin me të gjithë aspektet, elementët dhe faktorët apo problematikat, të cilat e karakterizojnë.

---

<sup>6</sup> Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (2014), kurrikulat dhe roli i tyre në organizimin dhe vlerësimin e procesit mësimor dhe edukativ në shkollë është i organizuar në Shkallë. **Shkalla përgatitore:** Edukimi në fëmijërinë e hershme; **Shkalla e parë:** Përvetësim i bazave për njohje; **Shkalla e dytë:** Përforsim i bazave dhe zhvillim; **Shkalla e tretë:** Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim; **Shkalla e katërt:** Përforsim i arritjeve dhe orientim në karrierë; **Shkalla e pestë:** Zhvillim themelor i përgjithshëm dhe profesional; **Shkalla gjashtë:** Konsolidim i arritjeve dhe specializim.

Më tej nxënësi prezantohet me fushën e të nxëniti “Shoqëria dhe mjedisi”, e cila në arsinë e mesëm (klasat midis X-XII) degëzohet, duke e kaluar njohjen dhe diskutimin e mëtejshëm të vlerave humane në lëndën e Qytetarisë. Në këtë moment nxënësi shkëputet nga interpretimi i vlerave humane si të ndërthurura në aspektet e / apo lëndët e tjera të edukimit dhe merr një orientim të drejtëpërdrejtë dhe specifik. Përmes fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, nxënësit zhvillojnë bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to. Kjo fushë synon që nxënësit të zhvillojnë vlerat themelore të qytetarisë, si: tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Përmes kësaj fushe, nxënësit aftësohen të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që: a) mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm; b) nxisin dialogun dhe njohjen e mjedisit.

Përmes fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, në këto shkallë, nxënësit zhvillojnë qëndrimet, aftësitë dhe njohuritë që i përgatisin ata të jenë qytetarë aktivë, të informuar dhe të përgjegjshëm për veten, shoqërinë dhe mjedisin. Përvojat mësimore të kësaj fushe të të nxëniti, i shërbejnë përmbushjes së kompetencave, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kulturor, kombëtar dhe më gjerë. Në këtë mënyrë nxënësit aftësohen për t’u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimension lokal, rajonal, kombëtar, evropian e global, duke ndërtuar identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët.

Falë këtyre njohurive në fund të shkallës së katërt nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë shembuj konfliktesh ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe presionit të grupit. Nxënësit janë gjithashtu në gjendje të analizojnë shkaqet e një situatë konfliktuale apo emocionale dhe propozojnë alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasojë duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit. Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë ndërmjet aspekteve fizike dhe humane, ndërmjet aspekteve individuale dhe shoqërore në realitetin e sotëm. Nxënësit janë në gjendje të vëzhgojnë dhe debatojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë, krahasojnë e vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

Në fund të shkallës së pestë, nxënësit marrin gjithmonë e më shumë një rol aktiv duke kaluar nga aftësia për të thithur dhe paraqitur njohuritë, tek përdorimi i tyre për të arritur

një objektiv të caktuar shoqëror. Kështu nxënësit kuptojnë dhe u përmbahen kodeve të sjelljes, në situata të ndryshme duke kombinuar aftësi të cilat kanë të bëjnë me kompetencat e:

- a. komunikimit dhe të shprehurit;
- b. të menduarit;
- c. personale;
- d. qytetare, si pjesë integrale e vlerave humane.

Nxënësit janë në gjendje që t'i aplikojë këto kompetenca për të përgatitur, prezantuar, drejtuar dhe marrë pjesë në një fushatë informimi për qytetarët në lidhje me një fushë apo temë të caktuar, duke u mbështetur në ide të reja, bazuar në rezultate të pritshme dhe të përcaktuara qartë (p.sh., fushatë informimi për mbrojtjen e mjedisit, për sigurinë, etj).

Falë këtyre aftësive të marra në nivelet e ndryshme të sistemit shkollor nxënësve u krijohen mundësi për përgatitjen e plotë me të gjitha kompetencat e nevojshme për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre, si edhe për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore si qytetarë të përgjegjshëm e kompetentë, si dhe për të konkurruar me sukses në tregun e punës. Ripozicionimi i sistemit shkollor si një strukturë për përgatitjen e nxënësve dhe të rinjve, jo vetëm me kompetenca profesionale por edhe me ato personale dhe shoqërore, është një hap cilësor në këtë drejtim pasi, për 85% të shqiptarëve, roli i shkollës në këtë proces konsiderohet si nga më të rëndësishmit (i dyti pas familjes) (UNDP 2015). Pra mund të themi se, në këtë mënyrë, sistemi shkollor mbulon pjesën kryesore të qasjes së vlerave humane dhe ofron kompetencat dhe njohuritë bazë për përdorimin e këtyre njohurive në shoqëri (Ministria e Arsimit dhe Sportit 2014).

Sikundër e thamë më lart në këtë seksion, pasurimi i kurrikulave të sistemit shkollor u harmonizua edhe nga një rol më aktiv i tre komponentëve të tjerë të rëndësishëm: a) familja; b) institucionet e kultit; c) shoqëria civile.

Pas kapërcimit të vështirësive sociale, ekonomike dhe morale të tranzicionit, familja shqiptare u rikthye në rolin e saj për edukimin me vlerat humane duke patur parasysh faktin se vetë shoqëria iu rikthye këtyre vlerave. Duke qenë se ato tashmë nuk shiheshin si antivlera, por edhe një ekspozim gjithnjë në rritje me botën e jashtme, solli në vëmendjen e prindërve tema shoqërore që më parë nuk njiheshin apo anashkaloheshin, siç ishin mjedisi apo qytetaria në një ambient shumëkulturore (UNDP 2010). E ndihmuar nga

institucionalizimi i këtyre koncepteve në kurrikulat e sistemit parashkollor, familja tashmë nuk ishte vetëm element përgjegjës por edhe i përgjegjshëm për edukimin me vlerat humane. Një rritje e presionit shoqëror për tematika si sjellja në shoqëri dhe në familje bënë të mundur që familja të kishte një mbështetje më të madhe në edukim. Kështu në një anketim të UNDP në vitin 2015, 91% e familjeve e konsideronin edukimin e fëmijëve dhe të rinjve me vlerat shoqërore si të një rëndësie themelore krahasuar me vitin 1994 kur kjo shifër ishte vetëm 41% (UNDP 2015). Një gjeneratë prindërisht, e cila është e aftë për të patur qasje mbi vlerat humane apo metodologjitë më moderne në fushën e edukimit shoqëror është një tjetër faktor pozitiv në këtë drejtim (OSFA 2010). Megjithatë, familja ka shumë për të bërë pasi shoqëritë e tranzicionit karakterizohen me ndryshime, transformime, kriza morale e kulturore, bullizëm dhe dukuri të dënueshme, nga një gjuhë e urrejtjes, komunikim vullgar e agresiv. Shpeshherë prindërit nuk arrijnë të komunikojnë siç duhet me fëmijët dhe, në disa raste, përdorimi i lojrave digjitale, në mënyrë të gabuar, konsiderohet si mundësi për fëmijët të pajisjen me aftësi digjitale në të ardhmen. Realiteti shqiptar, ku shpesh gjuha e urrejtjes fillon nga politika dhe mbaron tek gazetarët dhe personat publikë, si edhe aksesit shpeshherë i pakontrolluar që kanë fëmijët në mediat elektronike apo në ato sociale, kërkon shumë punë dhe investime nga familja që të kuptohen si disa nga rreziqet aktuale të edukimit me vlera të fëmijëve.

Një rol në rritje për të minimizuar efektet e këtij realiteti po luajnë edhe objektet e kultit. Me ristrukturimin e institucioneve fetare por edhe falë ndihmës dhe eksperiencës së përfituar nga partnerët ndërkombëtarë, ka një angazhim më të madh për edukimin e të rinjve. Kjo është edhe pasojë e faktit se shoqëria shqiptare e vlerëson si gjithnjë e më të rëndësishëm rolin e institucioneve fetare në edukimin e brezit të ri: kështu në vitin 1996, 80% e shqiptarëve mendonin se roli parësor i institucioneve të kultit është përhapja e vlerave fetare, ndërsa në vitin 2017, vetëm 40% e shqiptarëve ndajnë të njëjtin mendim, kurse rreth 60% mendojnë se feja ka një rol edhe në edukimin me vlerat të të rinjve, vecanërisht atyre me probleme familjare apo personale, për të mundësuar një integrim sa më të mirë të tyre në shoqëri (UNDP 2018). Ky lloj edukimi vjen jo vetëm nëpërmjet edukimit me vlerat morale, por edhe nëpërmjet dy komponentëve: a) zbavitjes; b) profesionalizimit. Në rastin e parë objektet e kultit ndërmarrin inisiativa, si për shembull organizata e bojskout apo të tjera organizata fetare të fokusuar në edukimin e të rinjve, të cilat përçojnë normat shoqërore, siç janë dashuria apo besimi tek te tjerët, ndihma për

njerëzit në nevojë apo të jesh i nderuar, nëpërmjet zbavitjes (Sinani 2010). Një tjetër mënyrë, e cila kryesisht i drejtohet grupmoshave me të rritura, është edhe afrimi me vlerat shoqërore nëpërmjet aktiviteteve profesionale, siç janë kurset e ndryshme për punonjës të kualifikuar (Sinani 2002). Megjithatë, duhet patur kujdes për një balancim sa më të mirë të komponentit shoqëror dhe atij fetar për të evituar rrezikun e një indoktrinimi radikal, i cili në disa raste mund të dalë jashtë kontrollit. Toleranca fetare mbetet një nga vlerat kryesore dhe të pakundërshtueshme të shoqërisë shqiptare, një vlerë e cila është transmetuar për gjenerata të tëra duke e kthyer realitetin tonë si një shembull pozitiv në mbarë botën (Fico 1997)<sup>7</sup>.

Shoqëria civile, tashmë më e konsoliduar, ka dëshmuar një ndjeshmëri më të lartë ndaj problemeve të edukimit shoqëror. Ka një rritje të ndjeshme të pritshmërive lidhur me rolin e shoqërisë civile në edukimin me vlerat. Në vitin 1998 rreth 65% e shqiptarëve mendonin se shoqëria civile luante pak ose aspak rol në edukimin e të rinjve dhe fëmijëve me vlerat humane, ndërsa në vitin 2016, mbi 70% e shqiptarëve mendonin se shoqëria civile mund të luaj një rol të rëndësishëm në këtë proces (Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë 2016). Një seri programesh që kanë për qëllim të luftojnë dukuri negative kryesisht të kohëve të fundit, siç janë bullizmi, agresiviteti dhe komunikimi konfliktual, janë ndërmarrë nga organizatat e shoqërisë civile (UNDP dhe SNV 2006). Për më tej, ka një bashkëpunim gjithnjë në rritje ndërmjet shkollës dhe shoqërisë civile në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për prezantimin e tematikave, por të cilat lënë për të dëshiruar në programin shkollor (UNDP 2010). Roli i organizatave të shoqërisë civile dhe medias duhet të jetë parësor për të parandaluar disa elementë që, siç theksuam më lart, janë karakteristika të shoqërisë shqiptare. Luftimi i këtyre dukurive ka nevojë më së shumti edhe për artin, kulturën, jo vetëm si mekanizëm imunizues por edhe si plotësim i nevojës shpirtërore dhe kulturore, si formë e cila krijon një standard qytetërimi dhe emancipimi, që krijon ekuilibër mes vlerave dhe sjelljeve të fëmijëve (Kunushevc 2019). Në këtë aspekt, shoqëria civile, në përgjithësi, dhe media, në veçanti, duhet të luajnë një rol parësor në përhapjen e tyre. Gjithsesi, në mjaft raste, media luan një rol negativ në këtë drejtim. Duke përçarur gjuhën e urrejtjes, mungesa e etikës, si nga ana e gazetarëve, ashtu edhe e të ftuarve apo pjesëmarrësve në transmetimet mediatike rrezikojnë të krijojnë

<sup>7</sup> Mbi 95 për qind e shqiptarëve konfirmojnë se ata ose anëtarë të familjeve të tyre nuk janë diskriminuar apo përjashtuar për shkak të përkatësisë fetare (UNDP 2018).

modele të gabuara për t'u ndjekur nga fëmijët dhe të rinjtë (OSFA 2010). Mesazhi se çdo mënyrë apo mundësi është e përligjshme për të arritur famën dhe pasurinë, krijimi i miteve televizive apo i influencës shoqërore, të cilat nuk transmetojnë vlera shoqërore apo kulturore për brezin e ri janë disa nga ndikimet negative që kanë nevojë për diskutim. Nuk është e rastit që në një studim të zhvilluar në vitin 2017, në Itali, me fëmijët e klasës së 7-të, 75% të djemve dëshironin të bëheshin në të ardhmen si Balotelli (një futbollist i njohur për natyrën e tij problematike dhe me vlera shoqërore mjaft të diskutueshme), ndersa 70% e vajzave dëshironin të bëheshin Velina (balerina në një nga programet më të njohura investigative në Itali) (Corriere della Sera 2017). Media është një pjesë thelbësore e shoqërisë civile dhe ka një rol të rëndësishëm në edukimin me vlerat humane të brezit të ri. Moskuptimi i këtij roli, jo vetëm që minon këtë proces, por shpesh krijon edhe efektin e kundërt tek të rinjtë, të cilët gjithnjë e më me intensitet drejtojnë vëmendjen nga media për të krijuar modelet e zhvillimit personal dhe krijimin e vlerave të tyre humane.

Sikundër e theksuam, në këtë seksion ka një rol gjithnjë në rritje të elementëve institucionalë në edukimin e brezit të ri, ndërsa familja është gjithnjë e më e informuar për sfidat që paraqet edukimi shoqëror i fëmijëve dhe të rinjve duke patur parasysht karakteristikat e shoqërisë shqiptare. Një rol parësor në këtë ripozicionim ka luajtur riorganizimi i kurrikulave shkollore në të gjitha nivelet. Në rast se mund të themi që në krahasim me periudhën e mëparshme roli i familjes, institucioneve të kultit apo shoqërisë civile është përmirësuar, roli i shkollës ka bërë një hap thelbësor përpara. Tabela 5 paraqet në mënyrë të përmbledhur evolucionin e edukimit me vlerat në shoqërinë shqiptare në periudhën aktuale.

**Tabela 5**

Qëllime/ Vlera	Edukimi institucional ose jo-institucional	Mjeti më influent për trasmetimin e vlerës	E konceptuar si
Të kesh një familje të qëndrueshme	Kryesisht jo-institucional	Familja	Vlerë personale/shoqërore
Të duash dhe të jesh i dashur nga të tjerët	Institucional, jo-institucional	Familja/Shkolla/Feja dhe Shoqëria civile	Vlerë personale/shoqërore
Të jesh i nderuar	Institucional, jo-institucional	Familja/Shkolla	Vlerë personale/shoqërore
Të ndihmohesh të tjerët	Institucional, jo-institucional	Familja/Shkolla/Feja	Vlerë personale/shoqërore

Të jesh profesionist i aftë	Institucional, jo-institucional	Familja/Shkolla	Vlerë personale/shoqërore
Të kesh besim	Kryeisht jo-institucional	Familja/Feja	Vlerë personale
Pozicion shoqëror i respektuar	Institucional, jo-institucional	Familja/Shkolla/Feja dhe Shoqëria civile	Vlerë personale/shoqërore
Të kesh influencë/pushtet	Institucional, jo-institucional	Shoqëria-Media	Vlerë personale/parësore
Të jesh i famshëm	Institucional, jo-institucional	Shoqëria-Media	Vlerë personale/parësore

## 5. Konkluzionet

Në periudha të ndryshme historike, qasja e vlerave humane në Shqipëri ka pësuar ndryshime të rëndësishme, si përsa i takon mënyrës së përçimit ashtu edhe aktorëve kryesorë në transmetimin e tyre. Ndoshta për nga amplituda e ndryshimit dhe mënyrës apo aktorëve që luajnë rolin kryesor në përhapjen e këtyre vlerave, realiteti shqiptar mund të përbëjë një rast të veçantë dhe mjaft interesant për t'u studiuar.

Nga një këndvështrim historik, mungesa e konceptimit të vlerave humane në një kuadër institucional përpara vendosjes së regjimit komunist, u pasua nga një institucionalizim gati radikal në përhapjen e këtyre vlerave. Shkolla dhe organizatat e kontrolluara nga shteti jo vetëm që vendosën një sërë kriteresh ideologjike në konceptimin e këtyre vlerave por arritën të minimizojnë rolin e familjes dhe të eliminojnë atë të fesë, të cilët në Shqipëri ishin larg të përbënin aktorët kryesorë në transmetimin e këtyre vlerave. Është e rëndësishme të theksohet se aktorët dhe mënyra e përhapjes së vlerave humane ka një impakt të padiskutueshëm për mënyrën se si konceptohet apo kuptohet kjo vlerë nga fëmijët dhe të rinjtë. Një tjetër realitet u shpalos gjatë tranzicionit shqiptar, ku këto vlera u anashkaluan dhe në disa raste u injoruan sepse aktorët kryesorë dhe më me influencë në transmetimin e vlerave humane ishin të papërgatitur për të marrë përsiper këtë rol të rëndësishëm. Riorganizimi i sistemit shkollor, duke u bazuar edhe në eksperiencat e vendeve të tjera evropiane, bëri të mundur rikthimin e vëmendjes së shkollës në lidhje me organizimin e kurrikulave të cilat pasqyronin dhe transmetonin këto vlera. Një qasje pozitive kishte në këtë ndërmarrje edhe një kujdes dhe njohuri më e plotë e familjes dhe e shoqërisë civile në pajisjen e individëve të së ardhmes me vlerat e nevojshme, si një element i domosdoshëm për bashkëjetesën në një realitet gjithmonë e më kompleks dhe shumëplanësh.



Megjithëse procesi i edukimit dhe përhapjes së vlerave humane ka marrë një zhvillim të rëndësishëm në vitet e fundit, përsëri Shqipëria paraqet akoma mangësi në lidhje me strategjitë që duhen adoptuar nga sistemi arsimor për zhvillimin e vlerave humane me më shumë sukses tek nxënësit dhe mësuesit.

Në këtë drejtim, duket e domosdoshme që të kihet parasysh një seri aspektesh, veprimtarish dhe prioritetesh siç i referohemi si më poshtë:

1. Edukimi luan një rol themelor dhe përbën një nga instrumentet më të rëndësishme dhe të fuqishme për të kontribuar për një botë më të mirë dhe më paqësore, prandaj të flasësh për edukimin nuk do të ishte e mundur pa përfshire vlerat humane, në rast se qëllimi është të zhvillojmë tek nxënësit ndjenjën e përgjegjësisë për të tjerët, duke mos o përqëndruar vetëm në interesat individuale, por e shprehur në veprime, nëpërmjet shembullit që japim.
2. Të flasësh mbi vlerat është e rëndësishme, por rezultatet në këtë rast arrihen vetëm në një nivel sipërfaqësor. Në këtë drejtim, ashtu siç është mbrojtur nga shumë filozofë, vlerat nuk mund të mësohen, por duhet të praktikohen dhe eksperimentohen. Nëse, për shembull, nxënësit mësohen të jenë të sinqertë, por në shoqëri ata e kuptojnë se njerëzit e ndershëm janë ata që vuajnë më shumë, nuk do të ketë interes nga ana e tyre për edukimin mbi vlerat. Prandaj është e rëndësishme të merret parasysh se ekziston një dallim midis njohjes së vlerave humane dhe asimilimit të tyre, midis njohjes së virtyteve dhe të qënit i virtytshëm (Krishnamurti em Ndrijo 2019). Njerëzit që konsiderohen kriminelë, për shembull, intelektualisht, mund ta dinë dhe njohin rëndësinë e vlerave humane, por tregojnë një paafësi për t'i zbatuar ato në jetë. Kështu që, strategjitë për edukimin mbi vlerat duhet të jenë në gjendje t'i përgjigjen kësaj sfide që duhet të jetë e pashmangshme dhe e pandashme nga praktika edukative, në se duam që edukimi të kontribuojë për lirinë, e cila vetëm mund të arrihet nëpërmjet kutlivimit të aftësive të brendshme. Për këtë, është e nevojshme një përshtatje më aktuale dhe më e fokusuar në kurrikulat shkollore, sidomos përse i takon metodologjive të zbatuara për transmetimin e këtyre vlerave.
3. Vlerat humane, në ndryshim nga fushat e njohurive të tjera kurrikulare, kanë nevojë për më shumë hapësirë dhe diversitet mjetesh dhe metodologjish në përcimin e tyre tek nxënësit. Kështu duhet një harmonizim më i mirë i orëve të

leksionit frontal me detyra specifike të fokusuara dhe të balancuara në mënyrë që perceptimi i këtyre vlerave të mos jetë vetëm një njohuri por një aftësi e gatshme për t'u zbatuar në situata dhe aspekte të ndryshme. Edukimi me vlerat humane është një fushë transdisciplinare, e cila ndërthuret me të gjitha lëndët, ashtu si dhe përfshin shumë aktorë, faktorë dhe realitete, prandaj dhe mënyra e ofrimit të saj duhet të jetë inovative dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Metodologjitë e propozuara për zbatimin e kurrikulave në këtë fushë duhet të përfshijnë edhe mundësitë e integritit të aktorëve të tjerë në këtë sipërmarrje. Nuk duhet të mbetet vetëm detyrë apo iniciativë e mësuesve të veçantë integrimi në mësimdhënie kur është e mundshme dhe e nevojshme bashkërendimi i aktiviteteve me organizatat jo-qeveritare, të cilat kanë eksperiencë në këtë fushë ashtu sikundër nuk mund të përjashtohet diskutimi i tematikave kryesore që i takojnë këtyre vlerave me të tjerë aktorë me influencë siç janë përfaqësuesit fetarë apo ata të medias.

4. Prandaj është e rëndësishme që politikat publike të krijojnë partneritete me institucionet e shoqërisë civile, të cilat kanë zhvilluar materiale pedagogjike lidhur me promovimin e aftësive transversale, bazuar në vlerat dhe qytetarimin, të cilat mund të analizohen nga Ministria e Edukimit dhe të vihen në dispozicion të komuniteteve shkollore. Këto partneritete strategjike, të arritshme, ndër të tjera, në veçanti përmes instrumenteve financiare evropiane, lejojnë që të fitohen koha dhe terreni në politikën publike në Shqipëri në këtë kontekst, përmes përdorimit të përvojave bashkëpunuese midis Ministrive dhe subjekteve të shoqërisë civile në vendet e BE-së, të cilat mund të shërbejnë si pikë referimi efektiv<sup>8</sup>.
5. Nje kujdes më i madh duhet të tregohet në ndërthurjen e këtyre kurrikulave me realitetin në të cilin ekspozohen nxënësit. Kështu teknikat dhe metodologjitë të cilat fokusohen në kontrollin e agresivitetit si verbal ashtu edhe fizik, në pasqyrimin e rreziqeve që mund të vijnë nga ekspozimi i pakontrolluar në mjetet e komunikimit masiv (si televizioni apo interneti), si edhe rreziku gjithmonë në

<sup>8</sup> Një shembull i tillë është Instituti Luzo Ilir për Zhvillimin Njerëzor në Portugali, i cili që prej vitit 2007 ka zhvilluar materiale edukative lidhur me edukimin mbi vlerat dhe qytetarinë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Edukimit në Portugali, dhe që në vitin 2019 nënshkroi një protokoll me këtë institucion publik për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Edukimit për Qytetarinë, i njëjti që ishte objekt studimi i një Vizite studimore nga Ministria e Edukimit të Shqipërisë në Portugali nën sponsorizimin e Këshillit të Evropës.

ritje i përdorimit të mediave sociale. Natyrisht që një dhunë verbale shpeshherë e kudogjendur në mediat apo realitetin e komunikimit shqiptar nuk ndihmon në këtë drejtim. Prandaj i takon edhe shkollës (përkrahë familjes) që të luajë një rol aktiv për parandalimin e këtyre fenomeneve. Një shoqëri gjithmonë e më e ekspozuar ndaj miteve bosh apo modeleve për t'u ndjekur të cilat transmetojnë vetëm antivlera përbën një tjetër aspekt në të cilin sistemi arsimor në Shqipëri duhet të luaj një rol themelor për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë se cilat janë burimet më të besueshme që duhen ndjekur të cilat kontribuojnë për promovimin e edukimit me vlerat humane.

6. Është e rëndësishme që vlerat humane të konsiderohen si kusht i domosdoshëm për një jetë të suksesshme nga e cila mund të përfitojë si individ ashtu edhe shoqëria. Konceptimi i vlerave humane nga ana e nxënësve, jo si një koncept abstrakt i cili i takon të gjithëve dhe askujt, por si një përpjekje dhe pasurim në së parë për vetveten. Është e domosdoshme që sistemi arsimor të ndihmojë nxënësit t'i kuptojnë këto vlera si një parakusht për integrimin e mëtejshëm evropian si të një individ në veçanti ashtu edhe të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.
7. Përpara se të kërkojmë të edukojmë nxënësit është e rëndësishme të mos harrojmë se është i domosdoshëm trajnimi i mësuesve, pasi njohuria dhe sjellja e tyre janë faktorë të rëndësishëm që kushtëzojnë njohurinë dhe sjelljen e nxënësve. Trajnimi i mësuesve do të thotë t'i japësh instrumentat dhe kushtet e duhura për të tejkaluar shkallën individuale për të hyrë në shkallën universale, e cila u bën të mundur mësuesve të kuptojnë se, përveç rolit që duhet të luajnë si arsimtarë, duhet ta shikojë dhe kuptojë vetveten si një qenie njerëzore që kujdeset për të tjerët, për jetën e shoqërisë dhe të planetit. Roli i mësuesve nuk duhet të jetë të mundohet të imponojnë besimet e tyre tek nxënësit, duke përdorur autoritetin e tyre, por t'i orientojnë në fazat e ndryshme të jetës, duke i ndihmuar këta të zhvillojnë krijimtarinë dhe frymën kritike që të bëhen të përgjegjshëm në lidhje me konkluzionet që nxjerin dhe vendimet që marrin.

Pajisja me vlerat humane të brezit të ri është ende një objektiv për të cilën shoqëria shqiptare ka jo vetëm detyrimin por edhe shumë rrugë për të bërë pavarësisht rezultateve pozitive të arritura sidomos në periudhën e dytë të tranzicionit. Në arritjen e këtij objekti duhet të harmonizohen në mënyrë koherente aktiviteti dhe kontributi i të gjithë aktorëve

institucional dhe shoqëror por, mbi të gjitha, i familjes, shkollës, shoqërisë civile dhe institucioneve të kultit.

Ky dokument na lejon të konfirmojmë – si duke patur parasysh koherencën historike ashtu si dhe kërkesën bashkëkohore – rëndësinë që Shqipëria duhet t’i japi investimit në lidhje me një model të Edukimit për Qytetarimin, e cila bazohet në zhvillimin e kompetencave personale dhe shoqërore të themeluara në vlerat njerëzore, e cila i hap rrugë zhvillimit të botës së brendshme të njeriut, atje ku banojnë këto vlera, të cilat kontribuojnë për rritjen e vetëndërgjegjjes dhe vetëdijes së qytetarëve dhe mundësojnë një pjesëmarje të vërtetë dhe sinqertë qytetare në të ardhmen, duke garantuar qëndrueshmërinë shoqërore dhe ekonomike të vendit përpara shfaqjes së sfidave lokale dhe globale.

## Bibliography

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë. 1992. *Strategjia e zhvillimit të institucioneve shkencore në Shqipëri*. Tirane.
- Alia, Ramiz. 1988. *Raport i mbajtur në kongresin e rinisë së punës së Shqipërisë. Zëri i Popullit*, 7 Nentor.
- Arbnori, Pjetër. 1993. *Intervistë mbi problemet e tranzicionit shqiptar. Rilindja Demokratike*, 3 Mars.
- Arthur, James & Davidson Jon. 2000. *Social Literacy and Citizenship Education in the school curriculum*, The Curriculum Journal 11 (1), 9-23
- Beqja, Hamit. 1986. *Analfabetizmi dhe problemet e tij në Shqipërinë e para luftës. Revista Pedagogjike*, 167: 91-115.
- Burawoy, Michael, et.al. *Uncertain Transition: Ethnographies of Change in the Postsocialist World*, Yale University Press, 1999
- Catalogue of OSFA Library. 2006. Tirana: Open Society Foundation Albania.
- Carvalho, Lourenço Xavier de. 2013. *Social Literacy: Values as Foundation of Competence*, Ph.D. Thesis, Portuguese Catholic University, Lisbon.
- Civici Ardian. 2013. *Shqipëria, një tranzicion i vështirë. Nga planifikimi i centralizuar dhe kolektivizimi drejt ekonomisë së tregut*, Tirane.
- Dasho, Erion. 2003. *Moda e OJQ-ve*. Shekulli, 29 Korrik.
- Dede, Spiro. 1996. *Kujtime*. Tiranë: Eurorilindja.
- Drost, Alan. 1995. *Shqipëria në rrugën e tranzicionit. Koha Jone*, 19 Qershor.
- Dushku, Qazim. 1991. *Shkatërrimi në sistemin socialo-economik. Koha Jone*, 6 Shtator.
- Elona Dhembo. 2013. *Administrata Publike në Shqipëri midis Politikës dhe Qytetarit*. Tirana
- Ermenji, Abaz. 1994. *Mbretëria Shqiptare. Përpyjekja*, 1: 60-71.
- European Commission (2014). *On Albania's Progress in the Fight Against Corruption and Organised Crime and in the Judicial Reform*. Tirana.

- European Council, 2006. *Key Competences for Lifelong Learning*. s.l.: Recommendation of the European Parliament and the Council of 18th December 2006, 2006. 2006/962/EC.
- Fatosi Magazine. 1982. *Si të zbatojmë detyrat e Partisë*. Fatosi, Mars.
- Fico, Bardhyl. 1997. *Religious tolerance in Albania*. Tirana: Friedrich Ebert Stiftung.
- Freedom House. 2000. *Annual survey and country scores 1998-1999*. On-line. Available from Internet, <http://www.freedomhouse.org/ratings/ratings.pdf>, accessed 20 November 2005.
- Galtung, Johan. 1997. *Albania: some pointers towards conflict transformation*. Oslo: Oslo University Press.
- Gjoka, Rasim. 1998. *Albanian state and media facing challenges of transition*. In *State, media and democracy*, ed. Institute of Democracy. Sophia: PHARE Democracy Program.
- Halliday, John. 1986. *The artful Albanian: memoirs of Enver Hoxha*. London: Chatto & Windus.
- Historia e Shqipërisë 2006. *Katalogu i Biblotekës Kombëtare*. Tiranë: Bibloteka Kombëtare
- Hoffe, Otried (2004), *Valores em Instituições, Democráticas de Ensino, Educ. Soc.*, Campinas, vol. 25, n. 87, p. 463-479, maio – agosto
- Hoxha, Enver 1969. *Organizatat e masave jane leva ne duart e partise* Tirane: 8 Nentori.
- Instituti i Shkencave Sociale. 1978. *Organizatat e masave si rripa transmissioni per punen e partise*. Tirana: Institute i Shkencave Sociale.
- Instituti i Zhvillimit te Arsimit. 2014. *Fusha: Shoqeria dhe Mjedisi*, Tirane.
- International Federation of Journalists. 1996. *Media Freedom in Albania*. [International Federation of Journalists.] Brussels: International Federation of Journalists.
- Këshilli i Evropës. 1995. *Albania: country strategy paper*. Tirane: Keshilli i Evropes.
- Klosi, Adrian. 1994. *Komunizmi i Hekurt Enverian. Perpjekja*, 1: 35-50.

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit. 1995. *Human rights report*. Tirane: Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- Koskins and Crick 2006. *Contributions of the home literacy environment to preschool-aged children's emerging literacy and language skills* in *Early Child Development and Care* 176(3-4), May 2006.
- Krasniqi, Afrim. 2004. *Problemet e shoqërisë civile në Shqipëri*. Tirana: Toena.
- Kunushevc, Labinot. *Kultura publike – edukimi më i rëndësishëm për fëmijë, “Familja dhe Shendetit”* <https://www.familjadheshendeti.com/kultura-publike-edukimi-me-i-rendesishem-per-femije/> lexuar ne 31/03/2020.
- Langer, Alexander. 1993. *The Albanian state*. *Albanian Observer*, 2: 21-41.
- Lopasic Alexander. (1992) *Cultural Values of the Albanians in the Diaspora*. In: Winnifrieth T. (eds) *Perspectives on Albania*. Warwick Studies in the European Humanities. Palgrave Macmillan, London.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës. 2014. *Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi*, Tirane.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës. 2014. *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar e Republikës së Shqipërisë*, Tiranë.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës. 1999. *Raporti Vjetor*, Tiranë.
- Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë 2016. *Përfshirja Sociale - Dokumenti Politik 2016-2020*. Tirane.
- Misha, Piro. 2015. *Shqiptarët dhe Modeli Social Evropian: Mangësitë, pengesat, sfidat, vizionet*. Friedrich Ebert Stiftung, Tirane.
- Morin, Edgar. 1999. *Seven Complex lessons in Education*, United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization - 7 place Fontenoy - 75352 Paris 07 SP – France.
- Ndrio, Eva. 2019. *For an Inclusive, Integrative and Holistic Philosophy of Education*, PhD Thesis, Lisbon University, Lisbon
- Nonaka, Ikujiro (1991), *Tacit Knowledge and Creativity: The Knowledge-Creating Company*, *Harvard Business Review*, 69 (6 Nov-Dec): 96–104

- Opinion and Questionnaire Institute. 2000a. *Gjendja e medias ne Shqiperi*. [Media landscape in Albania.] Tirana: Albanian Media Institute.
- Opinion and Questionnaires Institute. 2000b. *Statistical study on the media attendance*. Tirana: Opinion and Questionnaires Institute.
- OSFA, Open Society Foundation. 1998. *Probleme to pjesmarrjes vullnetare ne shoqerine civile*. [Problems of voluntary participation in civil society.] Tirana: OSFA.
- OSFA, Open Society Foundation. 2010. *Mungesa e eksperiences dhe vlerave shoqerore si nje nder problemet kryesore ne vepritarine e NGO-ve*. [The lack of experience as one of the obstacles in the activity of NGOs.] Tirana: OSFA.
- Pajaziti, Ali. 2017. *Vlerat dhe Shoqëria* <http://tesheshi.com/nga-ali-pajaziti-vlerat-dhe-shoqeria/>.
- Partners of Albania. 2001. *Report on the progress of Albanian civil society*. Tirana: Open Society Institute Albania.
- Pëllumbi, Servet. 2002. *Problemet e shoqërisë civile në Shqipëri. Politika & Shoqëria*, 5, 1: 9-30.
- Qeveria Shqiptare. 1992. *Programi i qeverisë Shqiptare për periudhën 1992-1996*. Tirana, Bibloteka e Parlamentit Shqiptar.
- Lleshaj & Çela. Teme Doktorature. *Drejt një ripërcaktimi të kontratës sociale*, faqe 82-84. Tirane.
- Saliani, Bajram. 2020. *Kurrikula me bazë kompetencat Dokumentet Kurrikulare*, Albas, Tirane
- Sinani, Fatri. 2000. *Funksionimi i shoqërisë civile në demokracinë Shqiptare*. *Politika & Shoqëria*, 1, 2: 19-39.
- Sinani, Gjergj 2010. *Feja dhe Edukimi*. Friedrich Ebert Stiftung, Tirane.
- Tarifa, Fatos. 1995. *Albania's road from communism: Political and social change in the period 1990-1993*. *Development and Change*, 26, 1: 133-162.
- Trusted, Jenifer. 1995. *Moral Principles and Social Values*. Routledge.



UNDP, United Nations Development Program. 1998. *Albania: human development report*. Tirana: UNDP Country Office.

UNDP, United Nations Development Program. 2000. *Albania: human development report*. Tirana, Albania: UNDP Country Office.

UNDP, United Nations Development Program. 2003. *Democratic governance framework*. Tirana, Albania: UNDP Country Office.

UNDP and SNV. 2006. *Civil society partnership assessment*. Tirana: UNDP Country Office.

UNDP, United Nations Development Program. 2010. *Albania: human development report*. Tirana, Albania: UNDP Country Office.

UNDP Programme of Cooperation 2012-2016 Government of Albania and United Nations Progress Report. Tirana 2015.

UNDP Assessment of Development Results and Evaluation of UNDP Contribution in Albania. Tirana 2015.

UNDP Toleranca Fetare ne Shqiperi United Nations Development Programme. Tirana 2018.